

#3 INFOGRAFIK

për diskriminimin në bazë gjinore në vendin e punës
gjatë periudhës gusht - tetor 2020



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga
Agjencia Suedeze për
Bashkëpunim Ndërkombëtar



Sweden
Sverige



A E DI SE:

hendeku gjinor në të ardhurat midis meshkujve dhe femrave në Maqedoninë e Veriut është 15% ¹?

shkelja e të drejtës për pagë të barabartë për punë të barabartë dhe e të drejtës për pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, përbëjnë shkelje të të drejtës së marrëdhënies së punës?

në periudhën 2017 - 2019, para gjykatave vendase nuk është iniciuar asnjë procedurë për shkeljen e të drejtës për pagë të barabartë për punë të barabartë dhe pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë ²?

GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE KOMITETI I HELSINKIT:



10

regjistroi 5 raste të diskriminimit të punonjëseve femra në bazë të seksit, gjinisë dhe statusit personal;

11

Siguroi ndihmë juridike falas për 6 punonjëse femra, në lidhje me: zgjatjen e të drejtës për pushim të lindjes për ato punonjëse të cilave u kishin skaduar kontratat e punës me kohë të caktuar, gjatë kohëzgjatjes së pushimit të rregullt të lehonisë dhe qasje të pabarabartë në avancim dhe rikualifikim në vendin e punës në krahasim me kolegët meshkuj;

1

inicoi 1 procedurë para Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për shkak të keqinterpretimit të Dekretit me fuqi ligjore të Ligjit për Marrëdhënie Pune, me të cilin vazhdohej e drejta për pushim të lehonisë.

1

inicoi 1 procedurë para Avokatit të Popullit për vërtetim të diskriminimit në bazë të seksit dhe gjinisë për shkak të qasjes së pabarabartë në avancim dhe rikualifikim në vendin e punës, krahasuar me kolegët meshkuj.

1

inicoi 1 procedurë para Inspektoratit shtetëror të punës për shkak të pushimit të pabazuar nga puna të një punonjëseje tekstili, e cila më herët kishte paraqitur ankesë, pasi që paga e saj ishte ulur për 50%, gjatë kohës që ishte e liruar nga detyrat e punës, si nënë e një fëmije deri në 10 vjeç.



+

Procedurat e filluara ende vazhdojnë.

/

Një procedurë përfundoi me rezultat negativ.

2

Dy nga procedurat e filluara para Inspektoratit shtetëror të punës në periudhën e mëparshme raportuese, kanë përfunduar. Njëra me rezultat pozitiv, kurse tjetra me rezultat negativ. Një procedurë akoma vazhdon.

¹ Enti shtetëror për statistikë, 2020. Anketë për strukturën e fitimeve të punonjësve, 2018 (shikuar më 18.11.2020).

² Më shumë punë për më pak para: Si të zvogëlohet hendeku gjinor i pagave në Republikën e Maqedonisë së Veriut? Mund ta gjeni në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/09/dokument-za-javni-politiki-poveke-rabota-za-pomalku-pari...-mkd.pdf>, (shikuar më 18.11.2020)

RAST:



Një punonjëse policie, e punësuar në vitin 2013 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përballet me diskriminim në bazë të seksit dhe gjinisë në vendin e punës, për shkak të pamundësisë për të përparuar në karrierë, e as për t'u trajnuar në mënyrë eksperte dhe profesionale në punë.

Gjegjësisht, në gjeneratën e nëpunësës së policisë, femrat, megjithëse i plotësojnë të gjitha kushtet, ende nuk kanë marrë vendime për avancim në pozitë më të lartë pune. Nga ana tjetër, kolegët e tyre meshkuj janë sistemuar në vendet e tyre të punës, e me këtë kanë përfituar rritje të pikëve të pagës. Sistemimet në vende të tjera të punës realizohen në bazë të aktit ligjor - Rregullore që është marrë në kuadër të Ministrisë.

Nëpunësja gjithashtu theksoi se pas përfundimit të pushimit të lindjes, puna e saj në terren, me urdhër gojor, është zëvendësuar me punë në zyrë, kurse femrave nuk u mundësohet rikualifikim profesional, siç u mundësohet meshkujve. Ndërkohë, nëpunësës së policisë iu dha vendim me të cilin i caktohet vend pune më i ulët.

Komiteti i Helsinkit, para Avokatit të Popullit, inicioi procedurë për vërtetim të diskriminimit në bazë të seksit dhe gjinisë. Procedura ende vazhdon.



Raporto diskriminimin në bazë gjinore në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në telefonat **02 / 3119-073** dhe **072 278-436** ose në adresën elektronike **helkom@mhc.org.mk**

Ky infografik u botua me ndihmë financiare të Bashkimit Evropian dhe bashkëfinancim nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmbajtja e infografikut është përgjegjësi vetëm e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose SIDA-s.